



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2024:082454

Datë: 17.05.2024

Numri i dokumentit: 05701787

P.nr.101/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarës Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtoren profesionale, Lumturije Fetahu Xhelili, duke vendosur në çështjen penale të të pandehurit, E.A., nga fshati L. Komuna Viti, për shkak të veprës penale në vazhdim vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 6 lidhur me nenin 77, të KPRK-së, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhërit ndëshkimor me numër PP.II.nr.347/2024, të datës 12.03.2024, pas konstatimit të dhënave në aktakuzë, të cilat ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor, me datë 17.05.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.347/2024, të datës 12.03.2024 dhe kjo gjykatë, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri, E.A., nga babai S., i lindur më me vendbanim në fshatin, L., Komuna e Vitisë, me shifër të konsumatorit, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse, nga data 06.09.2023 e deri me datën 21.12.2023, në fsh.L., K.Viti, në shtëpinë në shfrytëzim të tij, i pandehuri, si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka vjedhë shërbime komunale të energjisë elektrike duke shfrytëzuar në vazhdimësi energjinë elektrike e cila nuk është matur, në atë mënyrë që për shkak të borxhit të papaguar të njëjtit i është çkyçur energjia elektrike duke i vendosur njësinorin elektrik me komandë nga distanca dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike në terren nga ekipa e kontrollit të KEDS, është vërtetuar se i njëjti në mënyrë të paautorizuar është lidhur direkt në rrjetin elektrik jashtë pikës matëse nga ku është furnizuar me energji elektrike duke anashkaluar matjen dhe në këtë mënyrë me veprimet e evta të kundërligjshme, ka dëmtonuar KEDS-in, distrikti në Gjilan në shumë 458.40 euro.

-me këtë veprim ka kryer veprën penale në vazhdim vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 6 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 43 të KPRK-së dhe nenit 450, 458, 495 par. 1, 2 dhe 3 të KPPRK-së, të pandehurit të lartcekur:

I SHQIPTON **Dënim me gjobë**

Ashtu që për veprën penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi, i caktohet dënim me gjobë në vlerën prej 200.00 € (dyqind euro), të cilin dënim i pandehuri obligohet t'a paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, ose nuk mund t'a paguajë gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim do të barazohet me 20 € (njëzet) të dënimit me gjobë.

E dëmtuara KEDS, Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në vlerën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit ligjor.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 14.03.2024, në Gjykatën Themelore Gjilan, Dega e gjykatës në Viti, ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.347/2024, të datës 12.03.2024, ndaj të pandehurit E.A., nga fshati L., komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale në vazhdim vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 6 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së, si dhe kërkesa PP.II.347/2024, e datës 12.03.2024, për dhënien e urdhërit ndëshkimor me shqiptimin e dënimit me gjobë, me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPPRK-së.

Gjykata pas leximit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor, gjeti se në këtë çështje penalo juridike, janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPPRK-së për dhënien e urdhërit ndëshkimor dhe bazuar në nenin 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPPRK-së, vendosi që të pranojë kërkesën e lartëcekur, ashtu që të pandehurit t'i shqiptojë dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkëngjitura në të, ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë.

Deri te një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë: procesverbali nr. 2190374, i datës 21.12.2023, fotografitë e njuhësorit elektrik për gjendjen në terren, fatura për kalkulimin e rikthimit të humbjeve RH me nr.500250, e datës 22.12.2023, fatura mbi dëmin e shkaktuar DGLHP2313817, e datës 22.12.2023 si dhe dokumentacioni tjetër përcjellës, gjeti se këto janë prova të besueshme dhe të mjaftueshme mbi bazën e të cilave konstatohet bindshëm se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me aktin akuzues.

Andaj, bazuar në të lartë cekurat gjykata konsideron se me shqiptimin e dënimit me gjobë, ashtu siç është propozuar në kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor, mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së.

Duke pasur parasysh se në dispozitivin e aktakuzës është cekur vlera e dëmit mirëpo lidhur me llogaritjen e këtij dëmi nuk ka ndonjë ekspertizë të veçantë por e njëjta është bërë në bazë të kalkulimit të përgjithshëm RH, të cilën e bën vet e dëmtuara gjykata konsideron se të njëjtat nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesërishtë të kërkesës pasurore juridike andaj edhe bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-ës, të dëmtuarën KEDS për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil. Vendimin sa i përket shpenzimeve procedurale, gjykata e mori duke u mbështetur në nenin 450 par. 1 të KPP-së.

Nga të lartë cekurat dhe mbështetur në nenin 495 par. 1, 2 dhe 3, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.101/2024, Datë 17.05.2024

Gjyqtarja,
Blerina Jakupi Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, gjyqtare individuale të kësaj gjykate. Kundërshtimi nuk duhet domosdo të arsyetohet. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhërin ndëshkimor merr formën e prerë dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.